

Teknologji e kultivimit të popullatës “Reçi i Bardhë”

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola
QTTB Shkodër

Vend origjina: Lugina e Reçit, Malësia e Madhe. **Karakteristikat** kryesore fenotipike i përkasin racës “Montenegrin” (Leng et al 1962). Treguesit **klimatike tokësore** te ekosistemit janë ato te zonës jugore te Alpeve tona, **toka** te pjerrëta, lehtësisht acide ne lartësi 400-600 m mbi nivelin e detit, zone me mbi 1800 mm reshje ne vit dhe me shpërndarje vjetore kryesisht ne periudhën Tetor- Prill. Lugina është e mbrojtur nga erërat e ftohta, duke lejuar mbjellje relativisht te hershme. Periudha e vegjetacionit ne përgjithësi është e thate.

Cikli bimor i kësaj popullate është i shkurtër, 90-95 dite. **Ngjyra e kokrrës** është e bardhe. Ka tregues te mire te tolerancës ndaj thatësisë (ne përgjithësi kultivohet pa ujitje) po kështu është tolerant edhe ndaj krimbit te misrit. Kjo edhe për faktin se duke qene me cikël te shkurtër i shmanget infeksionit te breznisë se fundit te krimbit.

Forma e kallirit është tipike konike. **Kalliri** ka një baze te gjere dhe përfundon me maje.

Treguesit kimike te kokrrës:

Nr	Emërtimi i treguesit	Vlerat ne %
1	Proteina	12.96 - 14.29
2	Yndyra	5.30 - 6.08
3	Amidoni	69.6 - 71.2
4	Lizina	0.296 - 0.321
5	Triptofani	0.062 - 0.082
6	Metionina	0.133 - 0.141
7	Amiloza	13.2 - 15.1
8	Amilopektina	51.7 - 54.1
9	Zeine	37.4 - 42.47
10	Albumine +Globuline	19.77- 21.34
11	Gluteline	21.88 - 22.05

Kultivimi, prodhimi, ruajtja dhe përdorimi i popullatës “Reç i Bardhë” nga banoret e Malësisë se Madhe

Ne rajonin e Malësisë se Madhe ku është realizuar ky vrojtim, mbjellin rreth 50-60 ha ku përfshihen jo vetëm lugina e Reçit por edhe zona te tjera përreth deri ne buze te liqenit te Shkodrës. Tradita e përdorimit te bukës se bardhe te misrit bazuar pikërisht ne popullatën “Reçi i bardhe” është mjaft e përhapur jo vetëm

ne Malësinë e Madhe por edhe me gjere. Kërkesat për këtë tip buke janë te pranishme edhe ne qytetin Shkodër.

Përse kjo popullatë?

Ajo përfaqëson një nga njëmbëdhjete racat e misrit te kultivuara ne katër shekujt e fundit ne Evropën juglindore, e përqendruar ne zonat paramalore, ne rajonin e Shkodrës e te Malit te Zi.

Agroteknika bazë është kultivimi i kësaj popullate ne kushtet pa ujitje, ne toka te freskëta dhe përmbajtje humusi te mesëm e te larte. Raca “Montenegrin” ne te cilën bëjnë pjese popullatat e emërtuara si “Reçi”, “Vuçe”, “Çelike” etj. me kokërr te bardhe dhe te verdhe, kane qene ato me te përhapurat ne këtë rajon.

Ne vlerësim është marre “Reç i bardhë”, pasi ne traditën e zonës se origjinës ka qene me e përdorura dhe me drejtim përdorimi për buke te bardhe misri.

Popullata ne fjale gëzon këto karakteristika baze:

1. Cikël vegetativ i shkurtër 90-95 dite.
2. Kokërr e bardhe qelqore.
3. Tregues kimike te kokrrës shume te mire, proteine mbi 12%, yndyre mbi 5.5%.
4. Përshtatshmëri dhe stabilitet ne prodhimtari për zonën e origjinës.
5. Kapaciteti prodhues 30-35 kv/ha.
6. Tregues te shijes dhe buke pjekjes shume te mira.

Përdorimi:

Kultivimi i popullatës se misrit Reç i bardhe është shoqëruar me infrastrukturën tradicionale për produktin final, *bukën e misrit me karakteristikat dhe vlerat e veçanta, te pëlqyeshme e te kërkuara ne tregun konsumator*. Kjo infrastrukture përfshinë koçekët tradicionale për te grumbulluar pas vjeljes sasinë e misrit te prodhuar nga fermerët e zonës (rreth 15-17 ton), rikonstruksionin e disa mullinjve me ujë, pajisjet dhe ambientet tradicionale te gatimit e te pjekjes se bukës se misrit kryesisht shtëpiake . Ne traditën e zonës një buke e tille quhet “*buke qethi*” me peshe 0.5-1.5 kg.

Përveç përdorimit shtëpiak, ne mjaft furra buke te zonave urbane (Koplik e Shkodër) përgatiten dhe piqen për konsum ditor rreth 350-400 kg buke misri, nga misrat me kokërr te bardhe por vetëm një pjese (rreth 20 %) nga kjo popullate.

Interesi ekonomik i kultivimit të popullatës “Reçi i bardhë”

Me poshtë kemi bere vlerësimin e disa treguesve baze te interesit ekonomik. Nisur nga faktet e vrojtura dhe kontakti me fermerë te zonës na diktuan te

shprehim edhe disa tregues qe lidhen me efektivitetin e përdorimit te popullatave te misrit si kulture bujqësore me interes.

Jemi te bindur se me një organizim me te mire te infrastrukturës se përdorimit te këtij prodhimi, dhe aplikime te teknologjive te kultivimit me efikase, prodhimi do te ishte me i larte dhe te ardhurat po ashtu. E shoqëruar me një program përmirësimi te popullatës dhe kujdesit ne prodhimin e farës elementet e mëposhtëm do te rrisnin akoma me shume interesin ekonomik te kultivimit te kësaj popullate.

Interesi ekonomik i kultivimit të kësaj popullate:

- Kosto e prodhimit te 1 kg. misër ne zone ne kushte e një teknologjie te përshkruar me sipër është 22-25 leke për kg.
- Grumbullimi, ruajtja, shkoqja dhe bluarja; 5 leke për kg.
- Kosto e 1 kg. mielli: 35-38 leke.
- Një kg. miell konvertohet ne një 1.5 kg. buke.
- Çmimi i shitjes se 1/2 kg. buke te pjekur është rreth 40 leke.
- Çmimi i shitjes, misër kokërr ne treg jo me pak se 70 leke për kg.
- Prodhimi për ha është 25-30 kv/ha
- E ardhura nga një ha është mbi 200 000 leke.

Përveç konstatimeve te mësipërme, mendojmë se resurse gjenetike te tilla me vlere shume te mira mund te shfrytëzohen shume mire nga fermerët tanë. Sot ato mund te jene pjese e projekteve për zhvillim te qëndrueshëm ne shume zona me prioritet agroturizmin apo nismave për ushqime ekologjike, “produkte bio”.

%